



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1014/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bekim Zabergerja, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e AAK-së në Vushtrri, paraqitur kundër shpalljes së rezultateve përfundimtare nga QNR-KQZ, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Bekim Zabergerja, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e AAK-së në Vushtrri,

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 14:53 nga Bekim Zabergerja ku ka pretenduar se në Qendrat e Vendvotimit në Shkollën Filllore “Lumni Surdulli” në Samadrexhë, Shkollën Filllore “Rilindja” në Maxhunaj, Shkollën Filllore “Bajram Curri” në Dumnicë e Llugajt, Shkollën Filllore “Lutfi Musiqi” në Vushtrri, Shkollën Filllore “Mustafa Venhari” Vushtrri, Shkollën Filllore Naim Frashëri” në Vushtrri, dhe Shkollën Filllore “Ali Kelmendi” në Vushtrri ka pasur abuzim dhe vjedhje të votave duke transferuar tek anëtarët tjerë të subjektit politik të cilit i përket.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë një listë me emra dhe numra të telefonave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal Bekim Zabergerja janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, përveç një liste e cila nuk i plotëson kriteret të jetë si provë për tu vërtetuar për shkelja e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1014/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.